



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2020:064422

Datë: 16.03.2021

Numri i dokumen 01601503

P.nr.25/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË-

Departamenti i Përgjithshëm,përmes gjyqtares Emine Salihu, me Ref. e lartë Mimoza Mehmeti, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. A, nga Fsh.K. e E., K,Novobërde., për shkak të veprës penale Dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.3 nen par.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm PP.II-nr.716/2020 të datës 05.06.2020, të cilën e përfaqsonte prokurja e shtetit Sllavica Popovic, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 15.03.2021,në prezencë të palëve po të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri D. A., me pseodonim "M.", nga i ati L., dhe e ëma P., e lindur Gj., i lindur më dt. në fsh. K.. e E., Komine e Novoberdes., ku edhe jeton, ka të kryer shkollen e mesme te tekstilit, i martuar, babë i katër fëmijve, i pa punë ,i gjendjes së varfër ekonomike, me nr.personal:, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse ,

-Më datë 20.05.2020, rreth orës 14.30h, në Fsh..... e, Komuna e Novoberdes, në shtëpinë familjare , i pandehuri me qëllim të ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit, cënimit të dinjitetit ndaj të dëmtuarit djalit të tij S., ka ushtruar dhunë në familje përmes keqtrajtimit fizik, psikologjik dhe dhunës ekonomike në kundërshtim me nenin 2 nën paragrafi 2 të Ligjit për Dhunë në familje në atë mënyrë që i pandehuri duke qenë nën ndikimin e alkoolit me 1.60%, bën veprime

provokuese fillimisht me fjalë në drejtim të dëmtuarit duke e ofenduar dhe perulur me fjalë të ulëta, e kanos se do ta përzë nga shtëpia, me pas del ne oborr dhe merr një qekan me të cilin thyen një pjesë të kultivatorit, me qrast i dëmtuari per ta penguar që mos të thyente dhe sende të tjera, reagn duke ia marrë qekanin nga duart por i pandehuri revoltohet dhe vërsulet ne drejtim të tij duke dashur ta shqelmojë mirë nuk ia arrin, por e sulmon fizikisht duke e goditur me grusht në syrin e majtë, me q'rast si pasojë e veprimeve të tij tek i dëmtuari por që ka cënuar rëndë dinjitetin e tij, i ka skaktuar dhembje dhe shqetësim të madh emocional.

- me çka ka kryer veprën penale Dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.3 nën par.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e cituara ligjore ,nenin 4, 19, 38, 39,40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 71, 72, të KPRK-së,s i dhe nenin 365 dhe 451 të KPPK-ës të akuzuarin,

E GJYKON

Për veprën penale të dispozitivit të aktakuzës me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) Euro, dhe dënim me burgim në kohë zgjatje prej 4 muajve ,të cilat dënime i pandehuri nuk do ti vuaj dhe nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1 viti nga dita kur aktgjykimi të bëhet i formës së prerë , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale e në të kundërtën gjykata do t'ia revokoj dënimin me kusht.

I dëmtuari S. A., nga Fsh..... e E., për realizimin e kërkesës paurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil .

Obligohet i akuzuari ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzet e pesë euro)si dhe në emër të harxhimeve procedurale shumë e përlllogaritur në llogarinë përfundimtare të kësaj gjykate , të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në konform të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit i akuzuari , obligohet të paguaj taksën në shumë prej 30 euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Temelore në Gjilan ,ka ngritur aktakuzën PP.II-nr.716/2020 të datës 05.06.2020,, ndaj të pandehurit D.. A..., nga fsh. e E. Komuna e,

Novoberdes., për shkak të veprës penale Dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.3 nen par.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

I pandehuri D. A., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar deklaroj: se aktakuzën e lexuar nga ana e prokurores së shtetit e kam kuptuar në tërësi ,e ndiej vehtënjë fajtor dhe e pranoj fajsinë, e pranoj në tërësi veprën penale e cila më vihet në barrë sipas dispozitivit të kësaj aktakuze dhe atë për qdo pikë të aktakuzës, pranimin e fajit e bëj vullnetarisht pa kurfare dhune dhe presioni, nuk i kam ditur pasojat e kësaj veprë penale, nuk kam mundur ti kontrolloj veprimet e mija meqe kam qene nen ndikimin e alkoolit, qka që i kërkoj edhe falje publike djalit tim për veprime të tilla, është hera e parë qe jam prane gjykates, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë dhe betohem se kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit , jetojmë bashkë me një shtëpi me djalin tim S...., jemi pajtuar menjehere, i njëjti më ka falur gabimin , asnjëherë nuk kemi pasur probleme, kjo ka ndodhur rastësisht, ka qenë momentale , andaj edhe një herë betohem pranë gjykatës e kjo do të jetë hera e parë dhe e fundit e veprimeve të tilla.

Përfaqesuesja e akuzës, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 15.03.2021, deklaroj: se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, sepse pranimi është i mbështetur në provat materiale në shkresat e lëndës andaj konsideroj se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës që në tërësi ta aprovoj pranimin e fajësisë së të pandehurit.

I dëmtuari S. A., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar deklaroj: Të pandehurin D. A., e kam babë., është hera e parë e babait tim që është prane gjykatës, i njëjti ka bërë veprimet e tilla si në aktakuzë, mirpo unë menjëherë ia kam falur sepse e kam prind, nuk kemi kurfare mosmarveshje me të, jetojmë me nje shtepi , bashkë me babin tim kemi ardhur me veturë në gjykatë e cilën veturë unë e kam vozitur , qka me këtë nënkuptohet se nuk kemi kurfarë mosmarveshje me të njëjtin, i njëjti më ka kërkuar falje dhe unë ia kam falur tërësisht gabimin e bërë, është hera e parë që i njëjti ka bërë një veprim të tillë andaj edhe e kisha lutur gjykatën që i njëjti të lirohet nga përgjegjësia penale.

Pas dëgjimit të prokurores së shtetit,të akuzuarit, si dhe të dëmtuarit, gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore ,nga neni 248 paragrafi 2 të KPP për pranimin e fajësisë ,nga se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,pranimi mbështetet nga faktet e çështjes nga aktakuza e cila nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj ,duke u bazuar në këtë që u cekën më lartë ,gjykata e vërtetoi gjendjen faktike :

Se i pendehuri D. A., nga fsh..., Komune e Novoberdes., e ka kryer veprën penale Dhunë në familje nga neni 248 par.1 lidhur me par.3 nen par.3.1 dhe 3.2 të KPRK-së.

Gjyqëtarja e vetëme gjykuese , shpalli fajtor të pandehurin D. A., për veprën e cekur më lartë nga se veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit të pandehurit gjykata ia ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ,sipas nenit 73,të KPRK-së ku si rrethanë veçanarishtë lehtësuese gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajsinë ,sjelljen korrekte në gjykatë ,ka shprehur keqëardheje për kryerjen e kësaj vepre , është penduar si dhe faktin se më parë nuk ka qenë e dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, i kërkon falje publike të dëmtuarit dhe nuk kanë kurfarë të keqe në mes vete. Ndërsa , nuk ka gjetur ndonjë rrethanë pasaqërisht rënduese.

Sipas bindjes së kësaj gjykate ,caktimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit D. A., i është dënim i drejtë ,në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit ,si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit ,nga neni 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 të KPRK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 1.2 të KPRK-së.

Nga të cekurat e më sipërme e në bazë të nenit 365 të KPPK-ës,u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN ,DEGA NË NOVOBËRDË

Departamenti i përgjithshëm

P.nr.25/2020

Më:15.03.2021

*Ref. e lartë
Mimoza Mehmeti*

*Gjyqtarja
Emine Salihu*

KËSHILLA JURIDIKE :Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në gjykatën e Apelit në Prishtinë ,në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit .Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:064422
Datë: 16.03.2021
Numri i dokumentit: 01601503